Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**26.12.2023**	**05.01.2024**	**2023/1032**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.12.2023, **OE "AAG PROJEKT"- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr: **2023/1032**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **O.E Grup i Operatorëve Ekonomik DAJTING SH.P.K.; N.N.P. ATC COM SH.P.K.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i objektit te ri te Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER"** me nr. të prokurimit: **"635-23-10843-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMUNA E PEJES**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **3,070,665.98 Euro per Vitin 2023,2024,2025**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji për Prokurim Publik i konsoliduar

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit;

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës ;

Neni 59 Ekzaminimi. Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 69 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik;

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Rregullorja nr. 001/2022, per Prokurim Publik

Neni 40 Ekzaminimi. Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 79 Shkeljet e Renda:

Udhëzuesi për Prokurim publik 001/2023

Neni 10 - Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Te nderuar.

Me datën 07/12/2023 grupi i OE-ve AAG Projekt Sh.P.K. & Shkëmbi Sh.P.K. & Enggroup shpk & NNP World Medium", kane pranuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku ne te njëjtin njoftim Auloriteti Kontraktues - Komuna Pejë. ka rekomanduar për dhënie te kontratës grupin e OE-ve Dajtin Sh.P.K. dhe NNP AT Com Sh.P.K. si te pa përgje&jshëm.

Grupi i OE-ve ankues bazuar ne dispozitat e nenit 108A te LPP-se e ka kundërshtuar te njëjtin njoftim dhe ne afatin e parapare ligjor parashtron ketë Kërkesë për Rishqyrtim dhe atë me datën 1 1.12.2023. megjithatë AK - Komuna Peje asnjërin nga pretendimet tona ankimore nuk i trajton. përkundër këtij fakti kërkesën tone e refuzon sipas vendimit te datës 13.12.2023.

Prove: Kërkesa për ri shqyrtim e datës 11.12.2023 dhe vendimi i AK, date. 13.12.2023.

Pas publikimit te njoftimit - propozimit për dhënie te kontratës. grupi i OE-ve ankues për procedurën e lartë përshkruar te prokurimit ka kërkuar qasje ne dokumentacionin e grupit te OE-ve te propozuar për dhënie te kontratës. dhe operatoreve tjerë pjesëmarrës ne këtë procedurë te prokurimit te kualifikuar si te pa përgjegjshëm por me çmim me te ulet. prandaj Grupi i OE-ve ankues ne kuptim te nenit 109. te LPP-se, e parashtron këtë:

ANKESE

<u>PRETENDIMI ANKIMOR 1:</u>

Grupi i OE-ve ankues. bazuar ne nenin 108/A. te LPP-se. lidhur me nenin 60 te RRPP-se. nr. 001/2023, ka parashtruar kërkese për ri shqyrtim te vendimit ku është kundërshtuar propozimi për dhënie te kontratës duke faktuar se është propozuar për dhënie te kontratës grupi i OE-ve te pa përgjegjshëm.

AK - Komuna Peje, zyra e prokurimit, asnjërin nga pretendimet tona ankimore nuk i ka trajtuar fare dhe me këto veprime përkatësisht mos veprime ka shkelur nenin 108/A te LPP-se, paragrafin 8. pika 8.4. ku përcaktohet:

*8. Autoriteti kontraktues **do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:***

8.4 Autoriteti kontraktues ***ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.***

AK - Komuna Peje. zyra e prokurimit nuk e ka shqyrtuar vendimin e tije ne kuptim te asaj cfare ne si OE kemi kërkuar. rrjedhimisht me këto veprime ka shkelur edhe dispozitat e nenin 97. te rregullores për PP, nr. 001/2022. ku pika **E)** *"Mosrespektimi i rregullave për trajtimin e kërkesës për ri shqyrtim nga AK* konsiderohet si shkelje e rende e Ligjit për Prokurim Publik.

AK - Komuna Peje, zyra e prokurimit. ne vendimin e datës 13.12.2023. kundrejt kërkesës për ri shqyrtim te vendimit si arsyetim te vetëm potencon se kërkesa e parashtruar është vetëm nga lideri i Grupit OE "AAG Project" shpk dhe e njëjta nuk është nënshkruar dhe vulosur nga anëtaret tjerë te grupit.

Ne si Grup i OE-ve. ne oferte kemi prezantuar deklarata e krijimit te grupit, kemi ndare përgjegjësit ashtu siç përcaktohet me nenin 71. te LPP-se. lidhur me nenin 26. te RRPP- se, nr. 001/2022. përkatësisht mohimi i trajtimit te pretendimeve tona ankimore përsëri konsumon shkelje te nenit 97. te te njëjtës rregullore nga pika D) *Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore te prokurimit publik* dhe pika O), *Provat te mjaftueshme për sjellje te gabuar dhe jo profesionale te zyrtareve te prokurimit ndaj operatorit ekonomik.*

Kërkesa për ri shqyrtim, dhe ankesa ne OSHP, parashtrohet përmes platformës elektronike vula dhe nënshkrimi janë te formës elektronike dhe neni 26.1 i RRPP-se nr. 001/2022. pik b) e përcakton një gjë te tille:

"Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët. që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit **(deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar *nëse është i aplikueshëm)***

Çdo kërkese për ri shqyrtim ne AK, paraqitet vetëm nga Lideri i grupit, ngjashëm veprohet edhe me paraqitjen e ankesës ne OSHP. ku vetëm kompania jone ka dorëzuar me dhjetëra ankesa ne te njëjtën forme.

PRETENDIMI ANKIMOR 2:

AK - Komuna Peje. ka rekomanduar për dhënie te kontratës grupin e OE-ve. te pa përgjegjshme. lidhur me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nga pika 2.1 dhe 2.2 te FDT-se. pasi qe grupi i OE-ve "Dajting shpk & ATC Com" shpk, ne oferte si projekt menaxher ka prezantuar z. Fisnik Sylaj. i vete emëruar.

e oferte eshtë prezantuar kontrata e datës 10.11.2015. e lidhur me punëdhënësin "Dajting"shpk, mc orar prej **40 orë ne jave.** kurse ne Listën e Punëtoreve (ATK) ne emër te anëtarit ¦Dajting"shpk. z. Sylaj. rezulton qe punën e ka **sekondare** tek OE ¦'Dajting"shpk dhe jo si punëtor primare siç potencohet ne kontrate.

Sipas kësaj, rezulton qe janë prezantuar dokumente jo reale apo edhe fiktive përmes te cilave nuk

është prezantuar gjendja reale. pasi qe menaxheri i projektit është e pa mundur qe te jete ne marrëdhënie pune ne dy lokacione te ndryshme përgjatë kohës se njëjtë.

Si prove mund ti referoheni listës se ATK-se e cila është e ngarkuar ne sistem dhe te verifikoni një gjë te tille si dhe ueb faqes se ATK-se. përmes numrit pcrsonal.

Ngjashëm është vepruar edhe me menaxherin e punishtes ku është prezantuar z. Skender Loshi. Ne kontratën e lidhur me datën 03.01.2020, ne nenin 4. përcakton se orari i punës me punëdhënësin - anëtarin e grupit "ATC Com" shpk eshtë përcaktuar orari i punës prej **40 ore ne javе apo nga ora 08 deri ne 16.** Sipas listës se Punëtoreve te ATK-se, te prezantuar ne oferte, z. Loshi, rezulton te ketë **pune sekondare me anëtarin e grupit ATC Com shpk.** Pra edhe z Loshi me punë primare është i deklaruar ne institucion tjetër ne cilësi te mësimdhënësit ne Shkolle te mesme dhe jo me anëtarin e grupit AIC Com shpk. prandaj edhe kontrata e prezantuar ne oferte e lidhur me z. Loshin do duhej te konsiderohej si fiktive dhe jo reale dhe si e tille krijon alibi. meçe është e pa mundur qe një person te jete i kontraktuar me pune primare ne dy vende pune apo ne dy lokacione te ndryshme.

Si prove mund ti referoheni ueb faqes se ATK-se dhe rezulton qe i njëjti si punë primare ka institucion tjetër. ngjashëm verifikimi mund te behet përmes numrit personal i prezantuar ne oferte.

Pra grupi i OE-ve te cilët AK - Komuna Peje. ka rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar kontrata dhe prova fiktive te cilat nuk korrespondojnë me gjendjen reale. rrjedhimisht oferta e tyre ka qene dashur te eliminohet si e pa përgjegjshme dhe ne kuptim te nenit 7 dhe 59. te LPP-se. komisioni i vlerësimit te ofertave se bashku me zyrtarin përgjegjës te prokurimit barte përgjegjësi individuale.

Ne nenin 22 te Dosjes se tenderit te pjesa 2 e kontratës (Kushtet e Përgjithshme) përcaktohet:

*22.1 AK do te emëroje Menaxherin e Projektit le caktuar ne KVK **i cili do te jete përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimi te punëve gjate tere kohës, duke filluar nga dita e pare e fillimit te punëve e deri ne skadimin e periudhës garantuese te defekteve dhe për raportim te AK.***

Menaxheri i projektit dhe menaxheri i punishtes sipas nenit 69, paragrafi 4, pika 3. te LPP-se, **janë personel udhëheqës teknik dhe janë përgjegjës te drejtpërdrejte ndaj Autoritetit Kontraktues. Ne Republikën e Kosovës, me ligj te Punës dhe me ligjin për sektorin Publik orari i punës fillon ne ora 8 dhe përfundon ne ora 16.**

Lidhur me Menaxherin e projektit dhe Menaxherin e Punishtes po ashtu ekzistojnë shume vendime te nxjerra nga OShP ku qarte përcaktohet se Menaxheri i Projektit dhe Stafi tjetër kyç duhet te jete staf i rregullt i Kontraktuar nga Operatori Ekonomik.

Si prove mund ti referoheni vendimit te OShP-se me nr. 406/2023.

<u>PRETENDIMI ANKIMOR 3:</u>

Është i çuditshme fakti se si kërkesa jone refuzohet përkatësisht tentohet te manipulohet nga zyrtari përgjegjës i prokurimit ku potencohet se nuk është vulosur kërkesa nga te gjithë anëtaret. përkundër

faktit se autorizimet i janë deleguar liderit te grupit, ne anën tjetër favorizimi dhe shkelja e parimeve baze te prokurimit publik dhe akteve tjera nënligjore përfshire edhe kodin e etikes profesionale pasi qe ndaj grupit te OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës i është kërkuar sqarim dhe i është plotësuar dosja e tenderit me dokumente te cilat konsiderohen ndryshime materiale te përcaktuara me ncnit 59. paragrafi 2 te LPP-se ku përcaktohet: *"...Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues."*. AK - Komuna Peje. zyra e prokurimit. ka kërkuar dhe ka pranuar shkresa te cilat janë dhe konsiderohen si ndryshime materiale.

Grupi i OE-ve ka dorëzuar deklaratat për krijimin e grupit - konzorciumit ne mënyre te kundërligjshme dy deklarata te ndryshme, ne njërën ane si lideri i grupit eshtë caktuar OE "Dajting" shpk, ne anën tjetër OE "'ATC Com shpk. Deklarata e tille nuk i plotëson kushtet ligjore te nenit 71. te LPP-se dhe nenit 26. par. 1, pika a.b.c dhe d. te RRPP-se. nr. 001/2022 dhe AK, detyrimisht ka qene i obliguar ta eliminoi te njëjtën oferte si te pa përgjegjshme pasi qe:

Neni 10 i Udhëzuesit nr. 001/2023, sqarimi i tenderit gjate procesit te vlerësimit sqaron rastet kur dhe si AK mund te kërkojë plotësim te dokumentacionit:

lëse mungon deklarata e qarte ku te gjithë e anëtaret e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, tenderi duhet te refuzohet pasi qe ky është kusht administrativ.

AK - Komuna Peje, zyra e Prokurimit, me rastin e plotësimit te te njëjtës deklarate përgjatë procesit te vlerësimit te ofertave ka shkelur dispozitat ligjore, siç është nenit 7 dhe 59.2 i LPP-se, përkatësisht nenit 10 te Udhëzuesit për Prokurim publik. pasi qe ka munguar deklarata e qarte e grupit.

PRETENDIMI ANKIMOR 4:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës janë te pa përgjegjshëm pasi qe nuk i ka plotësuar kërkesat tjera lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, përkatësisht pajisjet teknike te detyrueshme për realizimin e kontratës ky te njëjtit nuk kane prezantuar pajisja ***"Çekan hidraulik qe montohet ne bager".*** Është dorëzuar marrëveshje për shfrytëzimin e pajisjes me OE "Ilea Gr", por nuk është prezantuar dokumenti unik doganor për pajisjen ne fjale.

PRETENDIMI ANKIMOR 5:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. nuk kane prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën tjetër kualifikuese , ndërsa AK- Komuna Peje ne piken 4 te kërkesës 9.1& 9.2. ka kërkuar një person te certifikuar - **diplomuar për kulme te rrafshëta.**

Grupi i OE-ve te cilët AK - Komuna Peje i ka rekomanduar për dhënie te kontratës nuk kane prezantuar asnjë dëshmi lidhur me certifikimin apo diplomimin e stafit te kërkuar lidhur me certifikimin e personit për kulmc te rrafshëta.

PRENTENDIMI ANKIMOR 6:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës përkatësisht lideri i grupit OE "Dajting" Shpk. ne shkresa te lendes ka bashkangjitur referencën ne emër te inxhinierit te elektroteknikes z. Hysen Gashi. ku është lëshuar ne cilësi te punëve paraprake te realizuara por i njëjti **nuk është i deklaruar si i punësuar tek OE "Dajting"shpk.** prandaj kjo reference do duhej te trajtohej si dokument fiktiv - jo real dhe do te duhej te eliminohej si oferte e pa përgjegjshme ligjërisht.

Ngjashëm është vepruar edhe lidhur me inxhinierin z. Rrahman Safedini. ku ne shkresa te lendes nuk është prezantuar ndonjë reference për pune paraprakisht te realizuara. rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën dhe dheshmin e përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ku ne piken 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar **CV, reference, përkatësisht përvoja e punës sipas periudhës se përcaktuar.**

Ne ofertën e grupit te OE- ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. Z. Arben Murseli, është prezantuar ne cilësi te drejtorit te anctarit "ATC Com" shpk. sipas certifikatës se ARBK-se. është nënshkruar deklarata nen Betim. ne emër te tije ne cilësi te Drejtorit te kompanisë. ndërsa tek lista e stafit mbështetës i njëjti është prezantuar ne cilësi te Personit te certifikuar për drenazhim te dheut dhe për trajtim te mbetjeve te rrezikshme inerte, është prezantuar si person i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune ne cilësi te menaxherit. ndërsa sipas kontratës se datës 01.05.2021 se lidhur me vetveten rezulton qe z. Arben Murseli është i kontraktuar me OE ,kAtc Com" shpk. me kualifikimet si :Ekonomist, gjeodet. person i certifikuar për armim. drcnazhim. mbrojtje inerte dhe menaxher i punishtes.

Këto dëshmi bien ndesh me kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate pasi qe AK- Komuna Peje. për secilën pozitë dhe pozicion ka kërkuar staf veç e veç dhe jo kualifikime gjithë përfshirëse, prandaj AK. detyrimisht ka qen dashur qe te njëjtën oferte ta eliminoj meçe kemi te bëjmë edhe me konflikt te interesit te përcaktuar me nenin 4 te LPP-se.

PRENTENDIMI ANKIMOR 7:

Grupi i OE-ve "Asfalti" Sh.P.K. & "Menti" shpk. është i pa përgjegjshëm pasi qe tek paramasa dhe parallogaria ne pozicionin H4 - Punët Montuese - Rrjeti i Kanalizimit. pozicioni nr. H4.4. *"Blerja dhe montimi i gypave të drenazhit dhe pjesëve jazonike, me gjithë materialin e nevojshëm.PESN-8, 0-125 mm. Në çmim të llogaritet edhe gjeotekstili 2.5m për m të gypit. Gjithnjë sipas detalit të dhënë nëprojekt ",* **nuk ka ofruar çmim fare.**

Ne piken 20.1, te DT. eshtë përcaktuar qe: *Të gjiiha çmimet e specifikuara në lender duhel të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohel qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore.*

Tek kërkesat e kapaciteti ekonomik dhe fmanciar eshtë kërkuar:

Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës. mjete te gatshmc ne llogari, apo limit kreditor , ne vlere prej 300 000 €

Dëshmia:

Dëshminë nga banka. jo me e vjetër se 6 muaj. Dëshmia mund te mos jete ne emër te projektit por qe e dëshmon se kemi mjete te gatshme ne banke ose **linje kreditore (limit kreditor) te aprovuar ne vlerën e kërkuar.**

Sipas bilancit bankar kompania juaj nuk disponon me mjete financiare ne vlerën e kërkuar. po ashtu letër konfirmimi i bankës Procredit Bank i datës 20/11/2023. nuk iu aprovon vlerën e përcaktuar prej 300.000.00€ euro. por letër konfirmimi potencon se *"Banka do ta konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar ne kapacitetin e tij jinanciar dhe nëse plotësohen kushlei e përcaktuara nga banka për financimin ne fiale "¦*

Nuk i plotësoni kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional:

Ne piken 9.1 dhe 9.2 - Kapaciteti teknik dhe profesional eshtë kërkuar qe OE apo grupi i OE-ve duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrate për pune te ngjashme (ndërtim i larte) ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te këtij njoftimi ne vlere prej 1.500,000.00 euro.

Grupi i OE-ve "Asfalti dhe Menli* Sh.P.K. sipas listës dhe dëshmive për projektet e realizuara ne tri vitet e fundit nuk ka prezantuar projekte sipas kërkesës se përcaktuar ne dosje te tenderit për ndërtim te larte por projektet e prezantuara kane te bëjnë me shtrim asfalti. ndërtim kanalizimesh. dhe pune tjera por punët te realizuara lidhur me ndërtimin e larte nuk e mbulojnë vlerën prej 1.500.000.00 eurosh.

Tek pika 2.4 dhe 2.5 e dosjes se tenderit eshtë kërkuar menaxher i projektit dhe menaxher i punishtes.

Dëshmia dokumentare:

Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe menaxherit te punishtes. Grupi i OE-ve ka prezantuar menaxher le projektit z. Hysni Morina. (i cili eshtë pjese i stafit edhe tek grupi i OE-ve "Raff II & Benita" shpk). ndërsa për menaxherin e punishtes nuk ekziston vendim fare.

Tek kërkesa numër 4 e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar staf mbështetës te certifikuar për kranist. armim. drenazhim te dheut. latues, saldues. etj., ndërsa ju si OE keni prezantuar certifikatat e stafit mbështetës për siguri dhe shëndet ne pune dhe jo sipas kërkesës kualifikuese.

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar inxhinier i emergjencave. ndërsa ju si OE nuk e keni prezantuar inxhinierin siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit.

PRENTENDIMI ANKIMOR 8:

OE "Olti Trasing" Sh.P.K, është i pa përgjegjshëm pasi qe Tek pika 2.4 dhe 2.5 e dosjes se tenderit eshtë kërkuar

Menaxher i projektit dhe menaxher i punishtes.

Dëshmia dokumentare:

lëndim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe menaxherit te punishtes, Para kontratë noteriale me vërtetim nënshkrimi te noteri ku specijikohet qartë angazhimi për këtë projekt, për slafin i cili nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajl e jundit. OE "Olti Trasing" si projekt menaxher ne Oferte ka prezantuar z. Safet Lipovica. ndërsa si menaxher te punishtes z. Resul Zeneli.

Lidhur me menaxherin e projektit. OE ka prezantuar marrëveshjen e cila nuk i plotëson kërkesat kualifikuese dhe e njëjta **nuk** eshtë lidhur ne prani te noterit. por eshtë prezantuar si *"kopje e zakonshme".* Sipas Akteve noterial ne fjale nuk janë vërtetuar nënshkrimet e palëve te përfshira ne marrëveshje. Ngjashëm eshtë vepruar edhe me menaxherin e punishtes. z. Resul Zeneli ku eshtë vërtetuar "kopja e zakonshme*.

Marrëveshjet e menaxherit te projektit dhe marrëveshja e menaxherit te punishtes. ne oferte janë prezantuar vërtetime te kopje dhe te prezantuara nga pala e trete. rrjedhimisht nuk janë prezantuar ashtu siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate.

Menaxheri i punishtes z. Resul Zeneli. sipas raportit te ATK-se i prezantuar ne oferte, rezulton qe i njëjti nuk eshtë staf me orar te rregullt por eshtë staf me status jo te rregullt - sekondar.

Stafi tjetër kyç - inxhinieret. te cilët nuk janë pjese e stafit te rregullt te OE "Olti Trasing". marrëveshjet - kontratat nuk janë te lidhura ne prani te noterit. ashtu siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit.

Ne piken 2.3 te FDT-se. kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar inxhinier i diplomuar i ndertimarise - drejtimi konstruktiv me 5 vite përvoje pune ne angazhim profesional - pas diplomimit.

Ju si OE. si inxhinier keni prezantuar z. Adil Shatri i diplomuar me datën 29/11/2019 dhe si i tille nuk e mbulon periudhën prej 5 vite - përvoje pune pas diplomimit.

Ne piken 2.10 te FDT-se eshtë kërkuar inxhinier i diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi. Ju si OE ne oferte keni prezantuar z. Erzen Halimi me kualifikim shkollor Bachelor i Gjeodezisë ndërsa kërkesa eshtë Inxhinier i Gjeodezisë.

Tek kërkesa numër 4. e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar staf mbështetës te certifikuar për kranist. armim. drenazhim te dheut. latues, saldues. etj., ndërsa ju si OE keni prezantuar certifikatat e stafit mbështetës për siguri dhe shëndet ne pune dhe jo sipas kërkesës kualifikuese.

OE bazuar ne kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar sipas raporteve dhe gjendjes financiare nuk disponon me vlerën e përcaktuar prej 300.000.00 €. per realizimin e projektit. përkatësisht letër përkrahja e prezantuar ne banke eshtë e dedikuar për projektin e iniciuar nga AK Ministria e Shëndetësisë dhe jo për ketë projekt.

<u>PRENTENDIMI ANKIMOR 9:</u>

OE "RAF 2" Sh.P.K, eshtë i pa përgjegjshëm pasi qe Tek pika 2.1 dhe 2.2 e dosjes se tenderit eshtë kërkuar

Menaxher i projektit dhe menaxher i punishtes.

Dëshmia dokumentare:

lëndim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe menaxherit te punishtes, ***Para kontratë noteriale me vërtetint nënshkrimi te noteri*** *ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, për stafin i ci/i nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e jiindit.*

Marrëveshjet me stafin e kualifikuar ju si OE si menaxher te e punishtes keni prezantuar me s. Hysni Morina (i njëjti eshtë prezantuar ne cilësi te menaxherit te projektit edhe nga OE "Mcnti Shpk për ketë projekt). rrjedhimisht ju si OE, keni prezantuar kontratën te pa noterizuar ne prani te noterit dhe ne kundërshtim me kërkesën e përcaktuar ne dosje te tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Ngjashëm eshtë vepruar edhe me Menaxherin e Punishtes dhe stafin tjetër profesional te prezantuar ne oferte. Nuk keni prezantuar kontrata - Para kontrata te nënshkruara ne prani te noterit dhe si te tilla janë ne kundërshtim me kërkesën e përcaktuar ne dosje te tenderit

Tek kërkesa numër 4 e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar staf mbështetës te certifikuar për kranit, armim. drenazhim te dheut. latues. saldues. etj., ndërsa ju si OE keni prezantuar certifikatat e stafit mbështetës për siguri dhe shëndet nc pune dhe jo sipas kërkesës kualifikuese.

Është prezantuar marrëveshja dhe diploma e inxhinierit te emergjencave e pa noterizuar dhe ne kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nc dosje te tenderit.

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara si me larte Grupi i OE-ve ankues. vlerëson se AK - Komuna Peje. vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave e ka realizuar ne kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore prandaj propozojmë qe eksperti shqyrtues. përkatësisht paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

URDHERESE

-Te aprovohet si e bazuar. ne tërësi ankesa e GR "AAG Projekt Sh.P.K. & Shkëmbi Sh.P.K. & ENG GRUOP & N.N.SH. World Medium";

-Te kthehet lënda ne Rivlerësim dhe te rekomandohet për dhënie te kontratës Grupi i OE-ve ankues.

-Te Urdhërohet AK - Komuna Peje, qe gjatë ri vlerësimit e ofertave ti respektoj ne tërësi dispozitat ligjore.

Te ndërmerren masa tjera ndaj zyrtareve përgjegjës te AK-se, pasi qe ky proces i prokurimit është karakterizuar me shkelje te renda te ligjit për prokurim publik dhe te akteve tjera nënligjore përfshire edhe nenin 97. te Rregullores nr. 001/2022.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të fundit financiare duhet te jet jo më pak se 2.500.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1** **Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo ne vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menagjimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur**
		Kërkesa 2 Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme	**Dëshmia 2** **Dëshmia nga banka, jo më e vjetër se 6 muaj.**
		në llogari, ose akces në kredi, apo limit kreditor, në vlerë 300,000.00 euro.	**Dëshmia mund të mos jetë në emër të projektit por që e dëshmon se keni mjete të gatshme në bankë ose linjë kreditore (limit kreditor) të aprovuar në vlerën e kërkuar.**
	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 1** **Operatori ekonomik apo grupi i OE, duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për punë të ngjashme (ndertim i larte) në tri vitet e fundit nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontratë - në vlerën minimale prej 1,500,000.00 euro.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1** **Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) të natyres se ngjajshme ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, të bashkangjitura me kopje te referencave apo certifikatave, raporteve te pranimeve në vlerën e kërkuar.**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		**Kërkesa 2** **Lista e stafit profesional.** **2.1) Menaxheri i projektit - OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.2) Menaxheri i punishtes - OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master ,Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.3) OE duhet te deshmoj se ka nje inxhinjer te diplomuar te ndertimtarise, drejtimi konstruktiv. Kerkohet te kete min 5 vite pervoje pune - angazhim profesional.** **2.4) OE duhet te dëshmoj se**	**Dëshmia 2** **Dëshmia për kërkesën 2.1-2.2-2.3-2.4-2.5-2.6-2.7-2.8-2.9-2.10-2.11 -Stafin profesional.** **-Një pasqyrë tabelare të puntorëve dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.** **Per stafin e kerkuar prezentuar duhet te dorezohen keto dokumente e deshmi** **-Kontratat valide kopje per stafin i cili gjendet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.** **-Parakontrate noteriale me vërtetim nënshkrimi te noteri ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, per stafin i cili nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.** **-Vendimi me shkrim për**

		ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Mbrojtje e Mjedisit, të jetë i çertifikuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor të Republikës së Kosovës për Mbrojte të Mjedisit, , kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. **2.5) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Elektroteknikes, drejtimi Energjetike (jo bachelor), kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.6) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Elektroteknikes, Drejtimi Elektronike. Kërkohet te ketë min. 5 vit përvojë pune –angazhime profesionale.**	**caktimin e menaxherit të projektit.** **-Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të punishtes.** **-Diploma e noterizuara. – çertifikata e noterizuara (per ata inxhinier që kerkohen).** **Sqarim: Ak mund të kërkoj për secilin dokument edhe dëshmi fizike.** **Aty ku thuhet pervoja e punes, gjithmon pervoja llogaritet per vitet pas diplomimit.** **Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës duhet diploma të jetë e nostifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.**	

		2.7) OE duhet te deshmoj se ka nje Inxhinier te Arkitektures Kerkohet te kete min 5 vite pervoje pune ne fushen e projektimit. **2.8) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinjer apo master te diplomuar te Makinerise, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale.** **2.9) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Hidroteknikë, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit.** **2.10) OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi, i liçencuar me licence valide, kërkohet te ketë min. 3 vite**	
		përvojë pune –angazhime profesionale pas diplomimit. **2.11) Një (1) Inxhinier i Emergjencave - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.**	
		Kërkesa 3 **Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë.**	**Dëshmia 3 Kopja e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopja licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë.**

		Kërkesa 4 **Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt; Një listë prej së paku Minimum 20 puntorë, minimum 10 puntorë duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë (për shkak të natyrës së rrezikshmërisë së punës).** **Minimum 1 person të çertifikuar për kranist (vinç).;** **Minimum 2 persona të çertifikuar për armim.;** **Minimum 1 person të çertifikuar për drenazhim të dheut dhe për trajtimin e mbetje të rrezikshme inerte.;** **Minimum 1 person të çertifikuar për kanalizim.;** **Minimum 1 person të çertifikuar për elektroinstalues.;** **Minimum 2 persona të çertifikuar për latues.;** **Minimum 1 persona të çertifikuar për saldues.;** **Minimum 1 person te çertifikuar/diplomuar per**	**Dëshmia 4 Lista e puntorëve e vulosur dhe nënshkruar. Kontratat e punës ose parakontrata në emër të projektit kopje. Kopja e çertifikatave diplomave për personat e çertifikuar.**

		punim me pllaka te keramikes dhe Granitit. **Minimum 1 persona të çertifikuar/diplomuar për kulme te rrafshta.** **Minimum 1 persona të çertifikuar per dhenjen e ndihmes se pare.** **Minimum 1 persona të çertifikuar per vedijesim per zjarrin dhe trajnimi per zjarrfikjen me aparate zjarrfikese.**	

		Kërkesa 5 **Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 1 te DT**	**Dëshmia 5 Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit, ndersa per ato mjete që nuk kanë libreza të qarkullimit Deklaratat unike doganore apo fatura. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

OE Grup i Operatorëve Ekonomik AAG PROJEKT; Shkembi Sh.p.k.; Enggroup SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM .. .është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) nuk shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse nuk ka ofruar çmimin me te lire se O.E.fitues, Oferta e këtij OE - € 2,981,010.38

Grup i Operatorëve Ekonomik „Raf II sh.p.k.; Benita Company... është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) nuk shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse nuk ka ofruar çmimin me te lire se O.E.fitues, Oferta e këtij OE - € 3,030,380.00

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **AAG PROJEKT**

Aktiviteti i prokurimit: "**Ndertimi i objektit te ri te Gjimnazit Shkencor Bedri Pejani – RITENDER"** me nr. të prokurimit: **"635-23-10843-5-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMUNA E PEJES**, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 06.10.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 20.11.2023, njoftimi B58 publikohet me datë 07.12.2023. OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, parashtron ankesë në OSHP me datë 22.12.2023.

OE ankuesi është shpallur si i pasuksesshëm ndër OE i rekomanduar është grupi i operatorëve ekonomik Dajting SHPK & ATC Com SHPK.

Tutje, OE ankuesi ka parashtruar pretendime lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, lidhur me GOE të rekomanduarit, si dhe për operatorët e tjerë ekonomik në procedurë.

PRETENDIMI ANKIMOR 1:

Grupi i OE-ve ankues. bazuar ne nenin 108/A. te LPP-se. lidhur me nenin 60 te RRPP-se. nr. 001/2023, ka parashtruar kërkese për ri shqyrtim te vendimit ku është kundërshtuar propozimi për dhënie te kontratës duke faktuar se është propozuar për dhënie te kontratës grupi i OE-ve te pa përgjegjshëm.

AK - Komuna Peje, zyra e prokurimit, asnjërin nga pretendimet tona ankimore nuk i ka trajtuar fare dhe me këto veprime përkatësisht mos veprime ka shkelur nenin 108/A te LPP-se, paragrafin 8. pika 8.4.

Kërkesa për ri shqyrtim, dhe ankesa ne OSHP, parashtrohet përmes platformës elektronike vula dhe nënshkrimi janë te formës elektronike dhe neni 26.1 i RRPP-se nr. 001/2022. pik b) e përcakton një gjë te tille:

"Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët. që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit **(deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar *nëse është i aplikueshëm)***

Çdo kërkese për ri shqyrtim ne AK, paraqitet vetëm nga Lideri i grupit, ngjashëm veprohet edhe me paraqitjen e ankesës ne OSHP. ku vetëm kompania jone ka dorëzuar me dhjetëra ankesa ne te njëjtën forme.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë, **konsideron se gjendet i bazuar**, për faktin se kërkesa për rishqyrtim/ ankesa parashtrohet nga lideri i grupit, dhe si e tillë lideri i grupit për operatorët ekonomik është OE ankuesi AAG Projekt SHPK.

PRETENDIMI ANKIMOR 2:

AK - Komuna Peje. ka rekomanduar për dhënie te kontratës grupin e OE-ve te pa përgjegjshme, lidhur me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional nga pika 2.1 dhe 2.2 te FDT-se. pasi qe grupi i OE-ve "Dajting shpk & ATC Com" Shpk, ne oferte si projekt menaxher ka prezantuar z. Fisnik Sylaj. i vete emëruar.

e oferte është prezantuar kontrata e datës 10.11.2015. e lidhur me punëdhënësin "Dajting"shpk, me orar prej **40 orë ne javë.** kurse ne Listën e Punëtoreve (ATK) ne emër te anëtarit Dajting"shpk. z. Sylaj. rezulton qe punën e ka **sekondare** tek OE 'Dajting"shpk dhe jo si punëtor primare siç potencohet ne kontrate.

Sipas kësaj, rezulton qe janë prezantuar dokumente jo reale apo edhe fiktive përmes te cilave nuk është prezantuar gjendja reale, pasi qe menaxheri i projektit është e pa mundur qe te jete ne marrëdhënie pune ne dy lokacione te ndryshme përgjatë kohës se njëjtë.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë sqaron se, AK në DT ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2:

2.1) Menaxheri i projektit - OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.

2.2) Menaxheri i punishtes - OE duhet te dëshmoj se ka një inxhinier te diplomuar ose master ,Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min. 5 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit.

Dëshmia 2

Dëshmia për kërkesën 2.1-2.2-2.3-2.4-2.5-2.6-2.7-2.8-2.9-2.10-2.11 -Stafin profesional.

-Një pasqyrë tabelare të puntorëve dhe personelit të kërkuar Emrin, mbiemrin, profesioni i kërkuar si dhe eksperienca duhet të dorëzohet në origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

Per stafin e kerkuar prezentuar duhet te dorezohen keto dokumente e dëshmi:

-Kontratat valide kopje per stafin i cili gjendet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.

-Parakontrate noteriale me vërtetim nënshkrimi te noteri ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, per stafin i cili nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.

-Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit.

-Vendimi me shkrim për caktimin e menaxherit të punishtes.

-Diploma e noterizuara. – çertifikata e noterizuara (per ata inxhinier që kerkohen).

Sqarim: Ak mund të kërkoj për secilin dokument edhe dëshmi fizike.

Aty ku thuhet pervoja e punes, gjithmon pervoja llogaritet per vitet pas diplomimit.

Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës duhet diploma të jetë e nostifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Kurse, në ofertën e GOE të rekomanduarit gjendet lista e stafit, e për të cilin pretendim lidhur me menaxherët e përmendur në **ankesë konsideroj se gjendet pjesërisht e bazuar,** për faktin se, sa i përket menaxherit të kontratës, i njëjti është edhe pronari i kompanisë, ndërsa

menaxheri i punishtes në CV i shkruan se është duke punuar në kompanin ATC dhe ka punë primare, përkundër që në listat e ATK-së janë të deklaruar si punë sekondare, andaj AK gjatë procesit të rivlerësimit duhet ti sqaroj dokumentet.

PRETENDIMI ANKIMOR 3:

Është i çuditshme fakti se si kërkesa jone refuzohet përkatësisht tentohet te manipulohet nga zyrtari përgjegjës i prokurimit ku potencohet se nuk është vulosur kërkesa nga te gjithë anëtaret, përkundër faktit se autorizimet i janë deleguar liderit te grupit, ne anën tjetër favorizimi dhe shkelja e parimeve baze te prokurimit publik dhe akteve tjera nënligjore përfshire edhe kodin e etikes profesionale pasi qe ndaj grupit te OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës i është kërkuar sqarim dhe i është plotësuar dosja e tenderit me dokumente te cilat konsiderohen ndryshime materiale te përcaktuara me nenit 59. paragrafi 2 te LPP-se ku përcaktohet: *"...Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues."*. AK - Komuna Peje. zyra e prokurimit ka kërkuar dhe ka pranuar shkresa te cilat janë dhe konsiderohen si ndryshime materiale.

Grupi i OE-ve ka dorëzuar deklaratat për krijimin e grupit - konzorciumit ne mënyre te kundërligjshme dy deklarata te ndryshme, ne njërën ane si lideri i grupit është caktuar OE "Dajting" shpk, ne anën tjetër OE "'ATC Com Shpk. Deklarata e tille nuk i plotëson kushtet ligjore te nenit 71. te LPP-se dhe nenit 26. par. 1, pika a.b.c dhe d. te RRPP-se. nr. 001/2022 dhe AK, detyrimisht ka qene i obliguar ta eliminoi te njëjtën oferte si te pa përgjegjshme pasi qe:

Neni 10 i Udhëzuesit nr. 001/2023, sqarimi i tenderit gjate procesit te vlerësimit sqaron rastet kur dhe si AK mund te kërkojë plotësim te dokumentacionit:

lëse mungon deklarata e qarte ku te gjithë e anëtaret e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës, tenderi duhet te refuzohet pasi qe ky është kusht administrativ.

AK - Komuna Peje, zyra e Prokurimit, me rastin e plotësimit te te njëjtës deklarate përgjatë procesit te vlerësimit te ofertave ka shkelur dispozitat ligjore, siç është nenit 7 dhe 59.2 i LPP-se, përkatësisht nenit 10 te Udhëzuesit për Prokurim publik. pasi qe ka munguar deklarata e qarte e grupit.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e tretë sqaron, në ofertën e GOE të rekomanduarit, në folderin 1.0, gjenden **marrëveshje bashkëpunimi**, në të cilën lidhet konzorciumi dhe tek neni 2 palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri **"Dajting"SHPK**, i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën, gjerësa **tek deklarata** e bashkangjitur deklarohen se palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri **"ATC COM"SHPK** i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën, si e tillë deklaratat nuk përkojnë me njëra tjetrën, përkundër që AK ka kërkuar sqarim dhe tutje OE i rekomanduar ka bashkangjitur në e-prokurim deklaratën e përmirësuar, mirëpo kjo deklaratë tani paraqet ndryshim material në ofertë, për faktin se ka përmirësime në dokument, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

PRETENDIMI ANKIMOR 4:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës janë te pa përgjegjshëm pasi qe nuk i ka plotësuar kërkesat tjera lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, përkatësisht pajisjet teknike te detyrueshme për realizimin e kontratës ky te njëjtit nuk kane prezantuar pajisja ***"Çekan hidraulik qe montohet ne bager".*** Është dorëzuar marrëveshje për shfrytëzimin e pajisjes me OE "Ilea Gr", por nuk është prezantuar dokumenti unik doganor për pajisjen ne fjale.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e katërt sqaron, AK në DT ka kërkuar:

Kërkesa 5 Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 1 te DT.

Dëshmia 5 Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit, ndersa per ato mjete që nuk kanë libreza të qarkullimit Deklaratat unike doganore apo fatura. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.

8	Çekan hidraulik qe montohet ne bager	1		

Tutje, në ofertën e GOE të rekomanduarit tek folderi 10.0 gjendet marrëveshja për qiramarrje, mirëpo mungon dokumentacioni unik doganor, ose fatura e blerjes etj, por AK mund të kërkoj sqarime për pajisjet të cilat i ka deklaruar në listë dhe marrëveshje para hapjes së ofertave andaj **pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar**

PRETENDIMI ANKIMOR 5:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. nuk kane prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën tjetër kualifikuese , ndërsa AK- Komuna Peje ne piken 4 te kërkesës 9.1& 9.2. ka kërkuar një person te certifikuar - **diplomuar për kulme te rrafshëta.**

Grupi i OE-ve te cilët AK - Komuna Peje i ka rekomanduar për dhënie te kontratës nuk kane prezantuar asnjë dëshmi lidhur me certifikimin apo diplomimin e stafit te kërkuar lidhur me certifikimin e personit për kulme te rrafshëta.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e pestë sqaron, AK në DT ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2:

Minimum 1 persona të çertifikuar/diplomuar për kulme te rrafshta.

Dëshmia 4 Lista e puntorëve e vulosur dhe nënshkruar. Kontratat e punës ose

parakontrata në emër të projektit kopje. Kopja e çertifikatave diplomave për personat e çertifikuar.

Tutje, në ofertën e GOE të rekomanduarit tek folderi 9.1 gjendet stafi në listë me certifikatë për "Dyshemetë e rrëshirës epoxy & Polyurethane dhe i papërshkueshëm nga uji", **pra nuk është i certifikuar për kulme të rrafshta**, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

PRENTENDIMI ANKIMOR 6:

Grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës përkatësisht lideri i grupit OE "Dajting" Shpk. ne shkresa te lendes ka bashkangjitur referencën ne emër te inxhinierit te elektroteknikes z. Hysen Gashi. ku është lëshuar ne cilësi te punëve paraprake te realizuara por i njëjti **nuk është i deklaruar si i punësuar tek OE "Dajting"shpk.** prandaj kjo reference do duhej te trajtohej si dokument fiktiv - jo real dhe do te duhej te eliminohej si oferte e pa përgjegjshme ligjërisht.

Ngjashëm është vepruar edhe lidhur me inxhinierin z. Rrahman Safedini. ku ne shkresa te lendes nuk është prezantuar ndonjë reference për pune paraprakisht te realizuara. rrjedhimisht nuk e plotëson kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ku ne piken 9.1 dhe 9.2 te FDT-se është kërkuar **CV, reference, përkatësisht përvoja e punës sipas periudhës se përcaktuar.**

Ne ofertën e grupit te OE- ve te rekomanduar për dhënie te kontratës. Z. Arben Murseli, është prezantuar ne cilësi te drejtorit te anëtarit "ATC Com" shpk. sipas certifikatës se ARBK-se. është nënshkruar deklarata nen Betim. ne emër te tije ne cilësi te Drejtorit te kompanisë. ndërsa tek lista e stafit mbështetës i njëjti është prezantuar ne cilësi te Personit te certifikuar për drenazhim te dheut dhe për trajtim te mbetjeve te rrezikshme inerte, është prezantuar si person i certifikuar për siguri dhe shëndet ne pune ne cilësi te menaxherit. ndërsa sipas kontratës se datës 01.05.2021 se lidhur me vetveten rezulton qe z. Arben Murseli është i kontraktuar me OE ,kAtc Com" shpk. me kualifikimet si :Ekonomist, gjeodet. person i certifikuar për armim. drenazhim. mbrojtje inerte dhe menaxher i punishtes.

Këto dëshmi bien ndesh me kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate pasi qe AK- Komuna Peje. për secilën pozitë dhe pozicion ka kërkuar staf veç e veç dhe jo kualifikime gjithë përfshirëse, prandaj AK. detyrimisht ka qen dashur qe te njëjtën oferte ta eliminoj meçe kemi te bëjmë edhe me konflikt te interesit te përcaktuar me nenin 4 te LPP-se.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e gjashtë sqaron, në ofertën e GOE të rekomanduarit përkatësisht folderi 7.0 gjendet lista e stafit profesional, në të cilën gjenden dëshmitë lidhur me personin e cekur në pretendim, i cili është punëtor me parakontratë, si dhe referenca është e lëshuar për projektet e kaluara, kurse AK në DT nuk ka specifikuar referencat, por vetëm ka kërkuar përvojë pune profesionale, për të cilën nuk ka dëshmuar përvojën sipas deklarimeve në CV, nuk ka të bashkangjitura dëshmi si dhe referenca e bashkangjitur nuk është e përfshirë në CV si përvojë ose projekt, andaj si e tillë **pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar,** për faktin se AK mund të kërkoj sqarime në rivlerësim.

Kurse, sa i përket pretendimit lidhur me personin e potencuar në pretendim, lidhur me inxhinierin z.RR.S, i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur para kontratën e punës për projektin

në fjalë të noterizuar, posedon diplomën si dhe CV, ndërsa referencat mungojnë, të cilat ka mundur ti kërkoj sqarime shtesë, **andaj pretendimi i OEankues gjendet pjesërisht i bazuar.**

Ndërsa, lidhur me personin në pretendim z.A.M**, pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar, për** faktin se i njëjti është drejtor në ATC, është i emëruar si person për drenazhim të dheut, i cili po ashtu posedon edhe certifikime të tjera, mirëpo AK përkatësisht njësia kërkuese mund ta sqaroj lidhur me pozicionet në punë, për arsye se prej certifikimit që ka, varet sa duhet të jetë i angazhuar në projekt.

PRENTENDIMI ANKIMOR 7:

Grupi i OE-ve "Asfalti" Sh.P.K. & "Menti" shpk. është i pa përgjegjshëm pasi qe tek paramasa dhe parallogaria ne pozicionin H4 - Punët Montuese - Rrjeti i Kanalizimit. pozicioni nr. H4.4. *"Blerja dhe montimi i gypave të drenazhit dhe pjesëve jazonike, me gjithë materialin e nevojshëm.PESN-8, 0-125 mm. Në çmim të llogaritet edhe gjeotekstili 2.5m për m të gypit. Gjithnjë sipas detalit të dhënë nëprojekt ",* **nuk ka ofruar çmim fare.**

Ne piken 20.1, te DT. eshtë përcaktuar qe: *Të gjiiha çmimet e specifikuara në lender duhel të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohel qe te shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore.*

Tek kërkesat e kapaciteti ekonomik dhe fmanciar eshtë kërkuar:

Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës. mjete te gatshme ne llogari, apo limit kreditor , ne vlere prej 300 000 €

Dëshmia:

Dëshminë nga banka. jo me e vjetër se 6 muaj. Dëshmia mund te mos jete ne emër te projektit por qe e dëshmon se kemi mjete te gatshme ne banke ose **linje kreditore (limit kreditor) te aprovuar ne vlerën e kërkuar.**

Sipas bilancit bankar kompania juaj nuk disponon me mjete financiare ne vlerën e kërkuar. po ashtu letër konfirmimi i bankës Procredit Bank i datës 20/11/2023. nuk iu aprovon vlerën e përcaktuar prej 300.000.00€ euro. por letër konfirmimi potencon se *"Banka do ta konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar ne kapacitetin e tij jinanciar dhe nëse plotësohen kushlei e përcaktuara nga banka për financimin ne fiale "*¦

Nuk i plotësoni kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional:

Ne piken 9.1 dhe 9.2 - Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar qe OE apo grupi i OE-ve duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrate për pune te ngjashme (ndërtim i larte) ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te këtij njoftimi ne vlere prej 1.500,000.00 euro.

Tek pika 2.4 dhe 2.5 e dosjes se tenderit është kërkuar menaxher i projektit dhe menaxher i punishtes.

Dëshmia dokumentare:

Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe menaxherit te punishtes. Grupi i OE-ve ka prezantuar menaxher le projektit z. Hysni Morina. (i cili eshtë pjese i stafit edhe tek grupi i OE-ve "Raff II & Benita" shpk). ndërsa për menaxherin e punishtes nuk ekziston vendim fare.

Tek kërkesa numër 4 e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar staf mbështetës te certifikuar për kranist. armim. drenazhim te dheut. latues, saldues. etj., ndërsa ju si OE keni prezantuar certifikatat e stafit mbështetës për siguri dhe shëndet ne pune dhe jo sipas kërkesës kualifikuese.

Tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar inxhinier i emergjencave. ndërsa ju si OE nuk e keni prezantuar inxhinierin siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e GOE "Asfalti SHPK & Menti SHPK" sqarojmë se, AK po ashtu ka eliminuar të njëjtin për të njëjtat arsye, megjithatë, pas verifikimit të paramasës së operatorit ekonomik, vërejmë se tek paramasa e ofruara përkatësisht pika H 4.4, i njëjti nuk ka ofruar çmim fare **andaj pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar, për faktin se,** konform rregullores 001/2022 për prokurim publik neni 40.16, AK mund të kërkoj sqarime për të njëjtën.

Kurse, lidhur me konfirmimin bankar, OE në ofertë ka të bashkangjitur një konfirmim nga banka Pro Credit e cila nuk e konfirmon që do ta mbështes, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Tutje, lidhur me projektet e realizuara, në ofertën e OE gjendet i lista me projekte, të cilat pjesa më e madhe është projekte, asfaltim, kanalizim etj, e cila nuk e mbulon vlerën, si e **tillë pretendimi gjendet i bazuar.**

Ndërsa, lidhur me caktimin e menaxherit të projektit dhe menaxherit të punishtes, **pretendimi gjendet i bazuar**, për faktin se vendim për caktim të menaxherit të punishtes nuk posedon fare, ndërsa menaxheri i projektit është i njëjti person edhe tek OE Raff II & Benita SHPK i emruar si menaxheri i punishtes, mirëpo sa i përket personit, meqenëse vetëm një operator rekomandohet për kontratë atëherë konsideroj se nuk paraqet problem.

Tutje, lidhur me pretendimin se nuk posedon inxhinier të emergjencave, **pretendimi gjendet i bazuar** për faktin se në ofertën e OE Asfalti Shpk, në listën e stafit profesional, i njëjti nuk ka bashkangjitur inxhinier i emergjencave.

PRENTENDIMI ANKIMOR 8:

OE "Olti Trasing" Sh.P.K, është i pa përgjegjshëm pasi qe Tek pika 2.4 dhe 2.5 e dosjes se tenderit

eshtë kërkuar

Menaxher i projektit dhe menaxher i punishtes.

Dëshmia dokumentare:

lëndim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe menaxherit te punishtes, Para kontratë noteriale me vërtetim nënshkrimi te noteri ku specijikohet qartë angazhimi për këtë projekt, për slafin i cili nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajl e jundit. OE "Olti Trasing" si projekt menaxher ne Oferte ka prezantuar z. Safet Lipovica. ndërsa si menaxher te punishtes z. Resul Zeneli.

Lidhur me menaxherin e projektit. OE ka prezantuar marrëveshjen e cila nuk i plotëson kërkesat kualifikuese dhe e njëjta **nuk** eshtë lidhur ne prani te noterit. por eshtë prezantuar si *"kopje e zakonshme".* Sipas Akteve noterial ne fjale nuk janë vërtetuar nënshkrimet e palëve te përfshira ne marrëveshje. Ngjashëm eshtë vepruar edhe me menaxherin e punishtes. z. Resul Zeneli ku eshtë vërtetuar "kopja e zakonshme*.

Marrëveshjet e menaxherit te projektit dhe marrëveshja e menaxherit te punishtes. ne oferte janë prezantuar vërtetime te kopje dhe te prezantuara nga pala e trete. rrjedhimisht nuk janë prezantuar ashtu siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontrate.

Menaxheri i punishtes z. Resul Zeneli. sipas raportit te ATK-se i prezantuar ne oferte, rezulton qe i njëjti nuk eshtë staf me orar te rregullt por eshtë staf me status jo te rregullt - sekondar.

Stafi tjetër kyç - inxhinieret. te cilët nuk janë pjese e stafit te rregullt te OE "Olti Trasing". marrëveshjet - kontratat nuk janë te lidhura ne prani te noterit. ashtu siç eshtë kërkuar ne dosje te tenderit.

Ne piken 2.3 te FDT-se. kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar inxhinier i diplomuar i ndertimarise - drejtimi konstruktiv me 5 vite përvoje pune ne angazhim profesional - pas diplomimit.

Ju si OE. si inxhinier keni prezantuar z. Adil Shatri i diplomuar me datën 29/11/2019 dhe si i tille nuk e mbulon periudhën prej 5 vite - përvoje pune pas diplomimit.

Ne piken 2.10 te FDT-se eshtë kërkuar inxhinier i diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi. Ju si OE ne oferte keni prezantuar z. Erzen Halimi me kualifikim shkollor Bachelor i Gjeodezisë ndërsa kërkesa eshtë Inxhinier i Gjeodezisë.

Tek kërkesa numër 4. e kapacitetit teknik dhe profesional eshtë kërkuar staf mbështetës te certifikuar për kranist. armim. drenazhim te dheut. latues, saldues. etj., ndërsa ju si OE keni prezantuar certifikatat e stafit mbështetës për siguri dhe shëndet ne pune dhe jo sipas kërkesës kualifikuese.

OE bazuar ne kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar sipas raporteve dhe gjendjes financiare nuk disponon me vlerën e përcaktuar prej 300.000.00 €. per realizimin e projektit. përkatësisht letër përkrahja e prezantuar ne banke eshtë e dedikuar për projektin e iniciuar nga AK Ministria e

Shëndetësisë dhe jo për këtë projekt.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimet e OE ankues kundër OE"Olti Trasing"SHPK sqaron se, nga AK i njëjti është i eliminuar.

Sa i përket pretendimit lidhur me menaxherët e projektit dhe punishtes, ekspertja shqyrtuese sqaron vendimet për caktimin e menaxherëve ekzistojnë dhe nuk ka nevoj të noterizohen, ndërsa kontrata e menaxherit të projektit z. S.L kontrata nuk është vërtetuar nënshkrimi te noteri, por vetëm është e noterizuar nga një person i tretë, ndërsa sa i përket menaxherit të punishtes z. R.Z ka të nënshkruar kontratën e punës me orar të plotë, mirëpo në listat e ATK-së është i deklaruar si punë sekondare. **Andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Lidhur me pretendimin për stafin të cilët nuk janë të rregullt, sqarojmë se, në ofertë janë të bashkangjitura kontratat të cilat janë noterizuar nga personi i tretë, ndërsa AK në DT ka kërkuar të vërtetohen nënshkrimet për para kontrata. **Andaj pretendimi gjendet i bazuar.**

-Kontratat valide kopje per stafin i cili gjendet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.

-Parakontrate noteriale me vërtetim nënshkrimi te noteri ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, per stafin i cili nuk gjindet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.

Tutje, sa i përket pretendimit lidhur me ing.A.SH **pretendimi gjendet i bazuar**, për faktin se data në diplomë është 2019 dhe si e tillë nuk e plotëson kriterin 5 vite pas diplomimit.

Lidhur me pretendimin për gjeodetin, **pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar**, për faktin se në ofertë është e bashkangjitur diploma bachelor I gjeodezisë, ndërsa kërkesa e AK-së ka qenë master I gjeodezisë, mirëpo meqenëse Gjeodeti posedon licencën, atëherë mund edhe të merret e mirëqenë.

Tutje sa i përket pretendimit lidhur me stafin mbeshtetës, OE Olti Trasing, nuk ka të bashkangjitura certifikatat conform kërkesës së AK-së, andaj **pretendimi I OE ankues gjendet I bazuar.**

Si dhe, lidhur me kërkesën e AK-së për kapitalin financiar në vlerë 300 000 euro ose mbështetja bankare, në ofertën e operatorit ekonomik Olti Trasing gjendet letër përkrahja nga banka NLB, e cila deklaron se i njëjti ka të aprovuar garancion bankar, si dhe limit të mbitërheqjes, por për Ministrinë e Shëndetësisë dhe e cila është e lëshuar me date 21.07.2023, gjerësa hapja e ofertave është bërë me date 20.11.2023, andaj **pretendimi I OE ankues gjendet I bazuar.**

PRENTENDIMI ANKIMOR 9:

OE "RAF 2" Sh.P.K, është i pa përgjegjshëm pasi qe Tek pika 2.1 dhe 2.2 e dosjes se tenderit është kërkuar

Menaxher i projektit dhe menaxher i punishtes.

Dëshmia dokumentare:

lëndim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe menaxherit te punishtes, ***Para kontratë noteriale me vërtetint nënshkrimi te noteri*** *ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt, për stafin i cili nuk gjendet ne liste te pagave se paku ne 6 muajt e fundit.*

Marrëveshjet me stafin e kualifikuar ju si OE si menaxher te e punishtes keni prezantuar me s. Hysni Morina (i njëjti është prezantuar ne cilësi te menaxherit te projektit edhe nga OE "Menti Shpk për ketë projekt). rrjedhimisht ju si OE, keni prezantuar kontratën te pa noterizuar ne prani te noterit dhe ne kundërshtim me kërkesën e përcaktuar ne dosje te tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Ngjashëm është vepruar edhe me Menaxherin e Punishtes dhe stafin tjetër profesional te prezantuar ne oferte. Nuk keni prezantuar kontrata - Para kontrata te nënshkruara ne prani te noterit dhe si te tilla janë ne kundërshtim me kërkesën e përcaktuar ne dosje te tenderit

Tek kërkesa numër 4 e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar staf mbështetës te certifikuar për kranit, armim. drenazhim te dheut. latues. saldues. etj., ndërsa ju si OE keni prezantuar certifikatat e stafit mbështetës për siguri dhe shëndet ne pune dhe jo sipas kërkesës kualifikuese.

Është prezantuar marrëveshja dhe diploma e inxhinierit te emergjencave e pa noterizuar dhe ne kundërshtim me kërkesat e përcaktuara ne dosje te tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimet e OE ankues kundër OE"Raf II" SHPK sqaron se, nga AK të njëjtin e shpallë të pasuksesshëm.

Tutje, sa i përket menaxherit të projektit, në ofertë janë bashkangjitura Vendimi mbi caktimin e menaxherit, CV, si dhe para kontrata dhe diploma e cila është e noterizuar nga një palë e tretë, si e tillë **pretendimi i OEankues gjendet i bazuar.**

Menaxheri i punishtes, në ofertë është e bashkangjitur vendimin mbi caktimin e menaxherit të punishtes, ndërsa para kontrata nuk është e noterizuar andaj **pretendimi i OEankues gjendet i bazuar.**

Si dhe i njëjti staf ka po ashtu një para kontratë si menaxheri i projektit për këtë aktivitet me OE Menti SHPK, e cila konsideroj mund të merret e mirëqenë, për faktin se në këtë aktivitet rekomandohet vetëm një operator ekonomik.

Lidhur me kërkesën nr.4 stafi mbështetës, sqarojmë se, në ofertën e Operatorit ekonomik Rafi II SHPK gjendet lista e stafit mbështetës, të cilët kanë vetëm certifikata për siguri dhe shëndet në punë, dhe jo certifikata për pozitat përkatëse të kërkuara, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Tutje, sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me inxhinierin e emergjencave, të njëjtin, OE Raffi II ka të bashkangjitur para kontratën, po nuk është e noterizuar konform DT-së, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Si përfundim, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës konsideroj se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim, për faktin se pretendimet e OE ankues kundër OE të

rekomanduarit, pretendimet e OE Asfalti SHPK & Menti SHPK si dhe OE Olti Trasing SHPK, OE RAF SHPK gjenden të bazuara sipas sqarimeve më lartë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AAG PROJEKT**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Blerina Huruglica